

Hajrush KURTAJ

**KONTRIBUTI I GRAVE DHE VAJZAVE NË LUFTËN
ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË ZONËN OPERATIVE TË
NERODIMES**

Nënzona Operative e Nerodimes¹, fillimisht shtrihej nga fshatrat e Drenicës: Shalë, Fushticë e deri në Gllloboçicë të Kaçanikut. Më vonë do të shtrihet nga gryka e Carralevës e deri në Gllloboçicë. Kjo zonë përfshin territorin e këtyre komunave: Lipjanit, Shtimes, Ferizajt, Kaçanikut dhe Shtërpcës. Nënzona Operative e Nerodimes kishte për mision që të planifikonte, të përgatiste dhe të zhvillonte operacione luftarake në të gjithë zonën e saj të përgjegjësisë nga Jezerci, Greme e Ferizajt, Mollopolci, Petrova, Ranca dhe shumë fshatra të tjera, të komunës së Shtimes, komunës së Kaçanikut dhe Hanit të Elezit e deri në kufi me Republikën e Maqedonisë.

Zona Operative e Nerodimes

Në këtë zonë të përgjegjësisë, do të zhvillonte operacione mbrojtëse të pengimit, me qëllim që të siguronte me çdo kusht rrugët kryesore të furnizimit me armatim dhe pajisje të tjera nga Republika e Maqedonisë për në malet e Sharrit. Zona Operative e Nerodimes kishte një zonë të gjerë të interesit, duke e përfshirë një pjesë të komunës së Lipjanit, komunës së Shtimes, Ferizajt, Shtërpcës, Kaçanikut, Hanit të Elezit e deri në kufi me Maqedoninë. Zona Operative e Nerodimes kufizohej me Republikën e Maqedonisë, Zonën Operative të Karadaku, Zonën Operative të Llapit, Zonën

¹ Jakup Krasniqi, *Kthesë e madhe, Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë 2006.

Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Pashtrikut.

Misioni i Nënzonës Operative të Nerodimes, i përcaktuar në këtë mënyrë, përfshin një mori detyrash të cilat për synim kryesor kishin të mbanin me çdo kusht rrugët e furnizimit me armatim, personel dhe pajisje luftarake nga Republika e Maqedonisë, zgjerimin e këtyre korridoreve dhe sigurimin e tyre me furnizime. Këto rrugë të furnizimit me armatim dhe pajisje ishin të rëndësishme për mbajtjen e intensitetit të veprimeve luftarake të UÇK-së, nëpër të gjitha zonat e lira, përfshirë edhe vetë hapësirën e lirë që mbante nën kontroll kjo zonë.² Forcimi i UÇK-së, organizimi i njësiteve guerile të saj dhe kryerja e aksioneve të armatosura, kundër pushtuesit serb, i frymëzoi shumë të rinj e të reja, të cilët u mobilizuan dhe morën përsipër zgjerimin e radhëve dhe formimin e njësiteve të UÇK-së në tërë vendin.

Kontributi i grave dhe vajzave në luftën çlirimtare në Zonën Operative të Nerodimes

Kontributi i grave dhe vajzave në luftën çlirimtare ishte krejt i natyrshëm, që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të bëhej preokupim, por edhe pikësynim i gruas shqiptare. Në historinë e popullit tonë, në luftërat për çlirim, ato asnjëherë nuk pushuan dhe kurrë nuk u pajtuan me robërinë, prandaj kudo ishte prezent edhe gruaja shqiptare. Kontributi i saj nis që nga lindja e një fëmije, duke i kënduar e thurur ninullat më të ilustruara për heronjtë kombëtarë. Ajo do të jetë e pranishme në çdo epokë të lavdishme të popullit tonë. Gratë shqiptare që nga koha e mbretëreshës Teutë e deri në kohën tonë gjithnjë kanë qenë të angazhuara në luftë për të mbrojtur atdheun, nderin e familjes, dinjitetin e kombit, të cilit edhe i kanë takuar. Është edhe koha më e re kur burgjet jugosllave u mbushën me vajza dhe gra të të gjitha moshave, prej të miturave e deri te mosha e pleqërisë, por asnjëherë nuk u thyen para torturave dhe gjyqeve të asaj kohe. Ndoshta nga gjithë kjo histori dhe sakrificë e brezave gjeti motivin pjesëmarrja e gruas në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që të realizojë një ëndërr brezash për çlirimin e vendit, pra me moton “Liri a vdekje!” Gratë luftëtare dhe dëshmore të UÇK-së ishin: Zahide Jashari, Aze Brahimaj, Hidajete Jashari, Sala Jashari, Igballe Jashari, Adile Jashari,

² Intervistë me gjeneralmajor Shukri Bujën, 23.05.2007, Lipjan.

Elheme Jashari, Xhevë Krasniqi - Lladrovci, Fatime Hetemi, Antigon Fazliu, Luljetë Shala, Myrvete Maksutaj, Hyrë Eminin, Lumnie Raka, Jehonë Raka, Mukadeze Lika - Muhaxheri, Emsale Frangu, Gjylsere Sahiti, Milihate Rama, Serbeze Gashi, Fatime Bazaj, Hadie Spahiu, Afërditë Spahiu, Njomëza Lipaj etj. Ajo që e pranishme që me rastin e themelimit të formacioneve të para ushtarake³ në përgjithësi, por edhe atyre që ishin angazhuar në zonat operative. Dashuria ndaj atdheut mbizotëroi mbi dashurinë prindërore. Këtu shihet madhështia e gruas shqiptare që lufton për lirinë e atdheut të fëmijëve dhe të popullit të saj. Sypatrembur, Hyra i bashkohet trimave e trimëreshave të kombit. Hyrë Emmini, gjatë luftës së UÇK-së ishte në strukturat komanduese të ZON-së, si njëra nga vajzat e rralla udhëheqëse në UÇK.

Kushtrimin e UÇK-së⁴, gratë e ndien shpejt dhe në zemrat e tyre u ndezën shkëndijat e jetës. “Të çohemi në luftë, të mbrojmë jetën e fëmijëve tanë!”. Kjo ishte motoja e grave të thjeshta të popullit, të cilat donin të luftonin. Përpyekjet e përbashkëta, në këtë luftë të madhe, u jepnin një karakter të ri marrëdhëniesve të tyre. Shumë vajza rrokën armët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes i shihnin ato të vinin natën vonë, më të shkathëta, më të pjekura. Jeta jonë ilegale⁵, lufta jonë e drejtë, u dha pjekuri para kohe, ashtu si kalitën edhe tërë ato vajza të reja shqiptare. Druajtjes së natyrshme të hapave të parë në rrugën e jetës dhe të luftës, ia zinte vendin shpalojsja e botës aq të pasur, aq të pastër, aq të ndjeshme, karakteristike për vajzat dhe gratë shqiptare.

Gruaja shqiptare⁶ kishte një etje të pashuar për të mësuar, për të qëndruar denjësisht krahas burrit për të kryer sa më mirë detyrat e rënda, të vështira dhe të komplikuar që shtronin para saj lufta dhe fitorja jonë. Këto raste, ashtu si dhe shumica e rasteve tjera, nuk tregojnë gjë tjetër vetëm se sa thellë ishte shtrirë dhe kishte gjetur vend në zemrën e popullit tonë, lufta jonë e drejtë, kjo tregon se dashuria për komb dhe atdhe, ishte dhe mbetet dashuria më e madhe, për të cilën mund të sakrifikohej çdo njeri. Edhe lufta ishte e vështirë dhe e rrezikshme, por pa luftë nuk mund të çlirohej Kosova.

³ *Feniksët e Lirisë, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, libri 18, Prishtinë 2020.

⁴ Hajrush Kurtaj, *Kontributi i femrës në luftën çlirimtare të Kosovës në Kaçanik dhe në Han të Elezit (1998-1999)*, 74.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

Me të hyrë në shtëpitë e tyre, ushtarëve tanë, u shtroheshin sofrat, u jepej buka e nxehtë dhe e ëmbël si sheqeri, ndonëse në të s'kishte asnjë grimë sheqeri, por ishte e ëmbël se qe gatuar me ndjenjën e dashurisë së pastër e të sinqertë të zemrave bujare të këtyre grave shqiptare lridashëse. Neve na dukej sikur të ishim në ndonjë ceremoni. Ku kemi hyrë na kanë pyetur “A keni nëna?” Me të marrë përgjigjen, ato shpreheshin: “Oh, ju pastë nëna, bijtë e nënës!”. Kujtimet e luftës çlirimtare janë një thesar i madh.

Në ato epope të lavdishme janë të shprehura ndjenjat, aspiratat e popullit. Atje gjen mendimin që kërkon zhvillim, për luftë, meqë ka kontradikta. Në të gjen veprimin kundër okupatorit. Në të gjen dashurinë, dhembshurinë e madhe për tokën, për një jetë më të denjë, të lirë.⁷ Në ditët e vështira, por heroike të luftës sonë çlirimtare, shtëpitë e tyre ishin bazat tona të veprimtarisë, të strehimit. Ato u bënë spitale për luftëtarët e plagosur. Njerëzit e këtyre shtëpive u bënë një me ne. Djemtë dhe vajzat që i kishin vënë qëllim vetes çështjen e madhe të çlirimit të atdheut. Djemtë dhe vajzat e këtyre shtëpive u bënë bashkëluftëtarët tanë⁸, duke i shtuar për çdo ditë radhët e luftëtarëve të lirisë kundër armikut. Nënata e tyre u bënë nënat tona, që u rrihte zemra me shqetësim kur na përcillnin dhe u qeshte fytyra sa herë na prisnin.

Ato nuk u trembën nga okupatori dhe shërbëtorët e tij, nga terrori, nga reprezaljet, nuk u trembën për fëmijët dhe shtëpitë e tyre të cilat i vunë në dispozicion. Kur iu shkatërruan dhe ua dogjën shtëpitë ato vazhduan me vendosmërinë edhe më të madhe nga mali në shërbim të Ushtrisë Çlirimtare. Lufta zgjerohej, luftëtarët dhe luftëtarët shtonin radhët e UÇK-së. Angazhimi i grave dhe vajzave për çdo ditë rritej. Ato përveç që dhanë bijtë dhe bijat, vazhduan të punojnë për luftën çlirimtare, sepse ishin nga ato nëna që thonë me krenari: “Gjakun e djemve dhe bijave ia kemi falë lirisë së Atdheut dhe Kombit!” Të njëjta ishin edhe nënat e të gjithë dëshmorëve dhe dëshmoreve, të cilat pas çlirimit disa herë i kemi vizituar. Edhe ato na kanë pritur ashtu, gjallë e gojën e qeshur dhe krenare, si çdoherë. Trimëria e të rënëve për liri, që luftuan dhe ranë heroikisht për çlirimin e atdheut, do të jetë gjithmonë burim frymëzimi për njerëzit tanë. Pastaj, kemi kujtuar e kemi folur me mall për bashkëluftëtarët

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

tanë, që me gjak e shkruan Epopenë e Çlirimit, Epope kjo e luftës së lavdishme të UÇK-së në krye me komandantin legjendar, Adem Jasharin.

Gratë dhe vajzat në formacionet ushtarake të UÇK-së të ZON-së

Të angazhuara nga fillimi i luftës ishin këto vajza dhe gra:⁹ Hyrë Emini, Hidajete Rexha, Merita Rexha, Lumnije Kaqiku, Nazmije Tershana, Lindita Viça, Gyltene Troni, Minire Terziu, Lumnije Raka, Jehona Raka, Tahire Rexhepi, Vahide Shahini, Rejhane Tusha, Milihate Shehu, Sevdie Shehu, Mukadeze Muhaxheri, Emsale Frangu, Violeta Raka, Lumnije Bela, Magbule Bela, Sevdie Frangu, Kadrie Piliqi, Mejreme Bela, Bukurie Demnika, Ylbere Berisha, Shahadie Raka, Vjollca Fazliu, Elmaze Musliu, Makfire Salihu, Demire Sallahu, Minavere Rashiti, Vjollca Rashiti, Valdete Dërguti, Milikije Maliqi, Milikije Rexha, Valbona Rexha, Nerxhivane Haziri, Emine Murtezi, Ibadete Jashari, Zymrije Ramusa, Gyltene Bajrami, Milihate Bajrami, Ferinaze Nuha, Zylfie Kashtanjeva, Hazire Kashtanjeva, Feime Ibrahim, Taibe Rexhepi, Elmaze Musliu, Kimete Halili, Haxhere Vranovci, Xhyllferije Vranovci, Shqipe Vranovci, Fitore Maloku, Milikije Bajrami, Feime Hyseni, Sinavere Shabani, Feride Rexhaj, Hasime Ademaj, Merrushe Gabrrica, Lavdrije Piraj, Valbona Derguti, Shahë Sllamniku, Dashurie Ukzmajli, Mexhide Guta, Zymrie Halili, Mirvete Troshupa, Zethane Zejnnullahu, Fitnete Derguti, Sanije Gashi, Haxhere Vranovci, Ibadete Hamiti, Zyrafete Tershani-Berisha etj.

Gratë ishin të pranishme që me rastin e themelimit të formacioneve të para ushtarake në përgjithësi. Në bazë të dokumentacionit të formacioneve të SHPUÇK-së, zonave, brigadave dhe të gjitha njësiteve rezulton se pjesëmarrja e gruas në formacionet ushtarake dhe luftarake ka qenë një angazhim i gjerë. Ajo ishte e pranishme në shërbimin shëndetësor, shërbimin logjistik, në policinë ushtarake, në njësinë speciale, në qendrën e ndërlihdjes, në shërbimin përcjellës, në sektorin e informimit, në sektorin e vëzhgimit, në detyra speciale, siç është minimi dhe deminimi, si luftëtare në vijën e parë të frontit. Gruaja nuk mungoi as në strukturat profesionale ushtarake. Angazhimi i saj i gjithanshëm, përkujdesja për strehimin e ushtarëve,

⁹ Hajrush Kurtaj, *KLA WAR - In Nerodime Operation Area*, Prishtinë 2015.

sigurimin e veshmbathjes, përkujdesja për transportin dhe vendosjen në institucionet përkatëse të ushtarëve të plagosur. Gjithashtu, gruaja u angazhua dhe dha kontributin e vet si ushtarë aktive në formacionet elite ushtarake, që morën pjesë në luftimet e rrepta me armikun. Disa me këmbëngulje refuzonin vendimet e komandantëve që të liroheshin nga angazhimet, në vijat e para të frontit, duke u thirrur në motivet më të ndryshme dhe natyrisht se komandantët bindeshin. Këso raste ka pasur në të gjitha zonat e luftës, por konkretisht po e potencoj vendosmërinë e katër ushtarëve të Brigadës 162 “Agim Bajrami” në Kaçanik, të cilat ballë për ballë me armikun duke luftuar, ranë në vijën e parë të frontit në Rakoc të Kaçanikut, më 9 prill 1999 e ato ishin: Lumnija Raka, Jehona Raka, Mukadeze Lika-Muhaxheri dhe Emsale Frangu.

Mukadezja, nënë e katër fëmijëve, dashuria ndaj atdheut mbizotëroi mbi dashurinë prindërore. Këtu shihet madhështia e nënës shqiptare që lufton për lirinë e atdheut të fëmijëve, të popullit të saj. Lumnija e Jehona (studente), ishin të vendosura, i kishin gjithmonë të qarta vendimet e tyre, kishin një qëndrim nga natyra që përshkruante personazhin e vajzave inteligjente, vajzave të edukuara mirë, të ndershme. Dëshironin që gjithmonë të jenë të sigurta në peshën e veprimeve të veta. Guximin që kishin këto dy dëshmore bëri që ato të gjenden në çdo situatë të luftës së pandalshme përballë çdo rreziku. Emsalja semimaturante, gëzimin më të madh në jetë ajo e përjetoi ditën kur më 20 mars 1999 veshi uniformën e UÇK-së, kur puthi flamurin kombëtar duke dhënë betimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe duke u radhitur në UÇK.

Përcaktimi i tyre për luftën ishte motivuar nga ndjenjat më sublimë e njerëzore: atdhedashuria dhe liria. Në mes tyre kishte vajza, gra, nxënëse të shkollës së mesme, studente, infermiere, mjekë etj., ku dashuria mbi atdheun mbizotëroi tek to. Këtu shihet madhështia e grave shqiptare që luftuan për lirinë e atdheut dhe kombit. Siç e potencuam edhe më parë disa prej tyre ranë heroikisht krahë për krahë me bashkëluftëtarët e tyre, në vijën e parë të frontit. Sipas luftëtarëve të lirisë, efekti moral e psikologjik i pranisë së gruas në formacionet ushtarake ishte evident dhe pozitiv. Natyrisht, këtu duhet të veçojmë edhe kontributin e vajzave dhe grave që nuk ishin të inkuadruara drejtpërsëdrejti në organizimin ushtarak, por që jetuan me të dhe për të, duke përfshirë nga vajzat më të reja, gratë e deri tek gratë e moshuara. Ato që dhuruan gjakun për të plagosurit, gatuan bukën,

pastruan dhe ndihmuan luftën çlirimtare të Kosovës.

Kur flasim për këto gra, që mbajtën me bukë UÇK-në, edhe pse fëmijët i patën vazhdimisht nën kërcënimin e granatimeve, del portreti i një gruaje të jashtëzakonshme. Por, për këto gra nuk është shkruar dhe folur mjaft. Me pjesëmarrjen aktive, në luftën për liri dhe pavarësi, gruaja shqiptare legjitimoi praninë e saj në sendërtimin e pikësynimit tonë: shoqërinë civile me ç'rast populli shqiptar përfundimisht do të bëhet subjekt i barabartë i bashkësisë së madhe dhe të civilizuar evropiane. Pjesëmarrja e gruas në ushtri është pjesë kyçe e pjesëmarrjes në menaxhim dhe udhëheqje të luftës. Pjesëmarrja e grave në ushtri është aspekt i rëndësishëm i demokratizimit të forcave të armatosura¹⁰, në kuptim të përfaqësimit të të gjitha grupeve shoqërore. Arritja e paqes dallon shumë nga funksionet tradicionale ushtarake, ku theksohet mbrojtja e popullsisë civile dhe ku përfshihen veçoritë e lidhura me zgjidhjen e konfliktit dhe rindërtimin.

Prania e grave në ushtri është pranuar pozitivisht në marrëdhëniet me popull si dhe kapacitetin e forcave për angazhim të grave. Gratë dhe vajzat kanë luajtur rol të rëndësishëm në UÇK. Këto nëna, këto gra, këto vajza heroike nuk dinin frikë, sikur zjarri t'i dilte deri në çati shtëpisë së tyre. Të tilla ishin nënat heroike të luftëtarëve të lirisë. Janë të shumta e të paharruara kujtimet për këto gra, për djemtë e tyre, vajzat e tyre dhe për shtëpitë e tyre që ishin në shërbimin tonë gjatë luftës çlirimtare. Ushtria Çlirimtare e Kosovës në radhët e veta ka pasur të rreshtuara shumë luftëtare, vajza e gra trimëresha që shkonin në beteja krahë për krahë luftëtarëve dhe luftonin pushtuesin serb pa iu dridhur syri apo qerpiku. Hija e vajzës apo gruas shqiptare në radhët e UÇK-së dhe në istikamet e luftës çlirimtare e madhëronte UÇK-në, duke e rritur besueshmërinë e saj te masat popullore dhe njëkohësisht e bënte të paluhatshëm besimin në fitoren e luftës çlirimtare. Sepse, inkuadrimi i vajzave dhe grave shqiptare në luftën për lirinë e Kosovës e bënte të plotë angazhimin e tërë potencialit luftarak njerëzor në këtë luftë, duke i dhënë asaj karakterin e mirëfilltë popullor.

¹⁰ Hajrush Kurtaj, *Kontributi i femrës në luftën çlirimtare ...*, 74.

Heroinat dhe dëshmoret e rëna në luftën çlirimtare të Zonës Operative të Nerodimes

Lumnije Sherif Raka (11.06.1976-09.04.1999),¹¹ u lind më 11 qershor të vitit 1976, në Kaçanik. Shkollën fillore e kreu në Bob të Kaçanikut, ndërsa shkollimin e mesëm e vazhdoi në Prishtinë, në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli”. Si nxënëse ishte shembullore dhe aktiviste e dalluar në jetën kulturore artistike. Pas mbarimit të shkollës së mesme, përkundër dëshirës për të punuar si motër medicinale, entet shëndetësore ishin të uzurpuara nga pushtuesi, kështu që ajo regjistroi studimet në Fakultetin Filozofik, Degën e Pedagogjisë. Asokohe në radhët e rinisë studentore, si gjithnjë, shquheshin për veprimtari të grupeve ilegale, të cilat vepronin kundër okupatorit. Shumë studente ishin radhitur në strukturat e UÇK-së dhe kryenin detyra të ndryshme në zonat jashtë luftimeve të drejtpërdrejta, si në furnizim, në informacion, rekrutim, propagandë, organizime të demonstratave në përkrahje të luftës çlirimtare.

Duke qenë se njësi i Kaçanikut ndodhej në luftime, në pikat ushtarake të UÇK-së në Jezerc, në vitin 1998 dhe pas betejës së 10 gushtit 1998 në Gabrricë, kundër forcave pushtuese, Lumnije Rakës, sikur iu shua dëshira për studime. Ajo tashmë kishte një dëshirë dhe ideal të vetëm, të kontaktonte me çlirimtarët dhe të radhitet në mesin e tyre. Më 20 tetor të vitit 1998, së bashku me Jehona Rakën, paraqitet vullnetarisht në Komandën e Brigadës për t’i kryer stërvitjet e nevojshme ushtarake dhe luftarake. Gatishmërinë e saj për t’iu bashkuar radhëve të UÇK-së e shprehu në prani të komandantit dhe zv.komandantit të Brigadës 162 “Agim Bajrami”, të cilët ndërkohë i informon lidhur me aktivitetet e saj dhe të vajzave të tjera të Kaçanikut, të cilat kishin shfaqur gatishmërinë për të hyrë në radhët e UÇK-së. Stërvitjet ushtarake i kryen individualisht gjatë tetorit dhe nëntorit 1998. Përgatitjet për detyrat e vëzhgimit i ka stërvitur me komandantin e skuadrës së policisë ushtarake, Fadil Çakën. Detyrat që kishte marr Lumnije Raka i kryen deri në fund të shkurtit, kurse nga fillimi i marsit 1999, në pikën e luftës, në Lagjen e Rakocit në Kaçanik me detyrë ishte si infermiere e luftës. Atë ditë, më 9 prill 1999, bashkë me Lumnijen ranë 27 ushtarë dëshmorë, kurse dy të tjerë u plagosën dhe u martirizuan 32 civilë e 3 u plagosën.

¹¹ Hajrush Kurtaj, *Flakë e pashuar*, Prishtinë 2016.

Jehona Sabit Raka (06.11.1976-09.04.1999), në radhët e luftëtarëve të UÇK-së u radhit edhe ushtarja Jehona Raka¹², e lindur më 6 nëntor 1976 në Kaçanik. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, ndërsa Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli” e kreu në Prishtinë. Në vitin 1995 u regjistrua në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filologjik, Dega: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Gjatë studimeve u shqua si studente e shkëlqyeshme, ku me sukses të merituar përfundoi vitin e tretë të studimeve. Gjatë vitit 1998 punoi vullnetarisht në Shtëpinë e shëndetit “Nëna Terezë” në Kaçanik. Jehona, shoqe të ngushtë e kishte Lumnije Rakën, e cila ishte edhe kushërira e saj. Ato kishin afërsi që nga rinia e hershme, meqë i kishte lidhur mosha, shkolla dhe jeta familjare. Por, me kalimin e kohës ato do të lidhen edhe me idealet e përbashkëta atdhetare. Jeta studentore i kishte lidhur ato edhe me rrethanat aktuale të kohës. Në radhët e rinisë studentore, asokohe vlonin bisedat për organizatat ilegale kundër pushtuesit. Mjediset studentore si gjithnjë ishin të mbushura me veprimtari të ilegales atdhetare. Në këtë kohë shumë studentë ishin radhitur në strukturat e UÇK-së dhe kryenin detyra të ndryshme në zonat e luftës. Më 20 tetor të vitit 1998, Jehona së bashku me Lumnije Rakën, paraqiten në Komandën e Brigadës për të kryer stërvitjet e nevojshme ushtarake e luftarake. Stërvitjet ushtarake i kryen individualisht me direktivat e Komandës gjatë tetorit e nëntorit të vitit 1998. Përgatitjet për detyrat e vëzhgimit i kanë stërvitur me eprorin e UÇK-së, Fadil Çaka.

Në këtë stërvitje ka marrë pjesë edhe Lumnije Raka dhe ushtarë e ushtare të tjera nga Kaçaniku. Pas kryerjes së stërvitjeve ushtarake Jehona me bashkëluftëtarët e saj sistemohet në njësitin e vëzhgimit, njësitë që vepron në qytetin e Kaçanikut. Këto ngjarje tërhiqen edhe më afër Jehonën dhe Lumnijën. Pas një kohe të veprimtarisë së fshehtë tani ato dyja vendosen në pikën e luftës, në Lagjen Rakoc të Kaçanikut. Si ushtare guximtare, ato përveç detyrave luftarake që kishin, kontribuan shumë edhe në përkujdesjet mjekësore ndaj të plagosurve dhe të sëmurëve, meqë të dyja ishin infermiere me profesion. Gjatë gjithë kohës, ato nuk kursyen asgjë nga vetja për t’iu ndihmuar luftëtarëve që kishin marrë plagët e lirisë. Guximin që

¹² Hajrush Kurtaj, *Kontributi i grave dhe vajzave në luftën çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Nerodimes: (1998-1999)*, Instituti i Historisë Ali Hadri-Prishtinë 2024,134-143 .

kishin këto dy heroina bëri që ato të gjenden në çdo situatë të luftës së pandalshme përballë çdo rreziku. Sakrifika e tyre që e madhe, supet e tyre bartën detyra të vështira luftarake deri në ditën e rënies së tyre në altarën e lirisë. Në mëngjesin e 9 prillit, të vitit 1999, armiku kishte sulmuar me shumë forca dhe me teknikë të rëndë ushtarake dhe luftarake. Synimi i armikut ishte që të mbante jashtë qytetit njësitet e UÇK-së, për të mos rënë qyteti në duar të tyre, me qëllim që ta siguronte Grykën e Kaçanikut për qarkullim të lirë. Jehona bashkë me Lumnijën atë ditë ishin në detyrat e tyre luftarake që i takonte çdo luftëtari në front. Pas tërë kësaj lufte që u zhvillua në kodrat përreth qytetit, në një moment krijohet situatë e tillë, kur popullata civile duhej të tërhiqej përtej, në malet mbi Kaçanik, që të strehohej nga granatimet e armikut. Në një kolonë që po tërhiqej nëpër Përroin e Rakocit¹³, i ndihmonin dhe ishin në ballë Jehona dhe Lumnija bashkë me disa shokë e shoqe ushtarë. Para se të arrinin në lartësinë absolute të përroit, nga një pritje e befashme e armikut bien në përleshje me forcat e armikut, Lumnija dhe Jehona, pranë njëra-tjetrës, bien bashkë, ashtu siç ishin tërë jetën të pandalshme dhe të vendosura në rrugën e çlirimit kombëtar”.

Emsale Izjadin Frangu (05.02.1981-09.04.1999),¹⁴ u lind më 5 shkurt 1981 në Kaçanik. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në mësimet dallohej me sukses të shkëlqyeshëm. E donte shumë profesionin e mjekësisë, por edhe duke parë nevojën e popullit ajo regjistrohet në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika” në Ferizaj. Mësimet në këtë shkollë i vazhdoi me sukses të shkëlqyeshëm, por nuk arriti t’i përfundojë. Ndërpreu maturën dhe radhitet në radhët e UÇK-së, në Brigadën 162 “Agim Bajrami” në Kaçanik, më 20 mars 1999, luftëtare e lirisë në ekipet e mjekësisë, në pikën e luftës, në Rakoc të Kaçanikut. Frymëzimin për atdhedashuri e kishte marrë nga prindërit, si dhe nga arsimtarët, sidomos nga profesori i respektuar, Mejdi Dalloshi, dëshmor i kombit. Gëzimin më të madh në jetë ajo e përjetoi ditën kur më 20 mars 1999 veshi uniformën e UÇK-së, kur puthi flamurin kombëtar duke dhënë betimin e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe duke u radhitur përkrahë shoqeve bashkëlufëtare Lumnije Raka, Jehona Raka, Melihate Shehu, Sevdije Shehu, Kadrije Piliqi, Nevzat Qallaku,

¹³ Hajrush Kurtaj, *Flakë e pashuar*, Prishtinë 2016, 171.

¹⁴ Hajrush Kurtaj, *Kontributi i grave dhe vajzave...*, 144-149.

Avdurrahim Shehu e të shumë bashkëluftëtarëve të tjerë, ndër të cilët edhe mjeku Nejazi Raka. Kur flakët e luftës kishin përfshirë tërë Kosovën luftëtarët e lirisë nuk mund të rrinin në shtëpitë e boshatisura nga djemtë dhe burrat, sepse ato nuk kishin lindur vetëm për t'i vajtuar vëllezërit e tyre të vranë e të masakruar nga dora kriminele serbe, por ato vendosën që të radhiten në radhët e UÇK-së dhe të vendosura krahë për krahë me vëllezërit e tyre në vijën e parë të frontit. Duke mbrojtur popullatën civile në tërheqje, filloi një betejë e ashpër në mes të forcave serbe dhe UÇK-së. Në krye të kësaj detyre bie heroikisht Emsale Frangu, më 9 prill 1999, në Rakoc të Kaçanikut.

Mukadeze Lika-Muhaxheri (12.04.1960-09.04.1999),¹⁵ ishte bija e Bafti dhe Hazbije Likës. Bashkëshortët Lika me dashuri e përkushtim prindëror, lindën dhe rritën tetë bija dhe dy djem. Mukadezja ishte fëmija i gjashtë me radhë. Mukadezja u lind më 12 prill të vitit 1960 në Kaçanik, ku kreu shkollën fillore. Po në qytezën e saj të dashur kreu edhe shkollën e mesme ekonomike. E frymëzuar nga tradita familjare dhe nga literatura me përmbajtje kombëtare liridashëse, në mars dhe prill të vitit 1981, Mukadezja dhe motra e saj Xhevahirja marrin pjesë në demonstratat studentore, të cilat asokohe i kishte organizuar rinia atdhedashëse e Kosovës. Së bashku me motrën dhe me shoqe të tjera morën pjesë në demonstratat e zhvilluara në Prishtinë, në Ferizaj dhe në Kaçanik, përkrah vëllezërve të tyre që kishin ngritur grushtet kundër sundimit kolonialist jugosllav. Ideali i lirisë vlonte në shpirtin e saj liridashës dhe kryengritës.

Në mars të vitit 1998, kur legjendari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari dha kushtrimin e lirisë, ajo ishte përgatitur për t'u rreshtuar në radhët e luftës çlirimtare. Më 16 mars të po atij viti, Mukadeze Lika ndodhet në ballin e nënave kosovare, që ishin nisur rrugës për në Drenicë, por policia serbe me dhunë i ktheu nga rruga për në Fushë-Kosovë. Mukadezja mori pjesë në shumë aktivitete atdhetare, në protestat e demonstratat që u zhvilluan sidomos në mars dhe në prill të vitit 1998, në përkrahje të luftës që kishte filluar në Drenicë dhe në Dukagjin. Me rastin e zgjerimit të radhëve të UÇK-së në zonën e Kaçanikut, Mukadeze Lika, nënë e katër fëmijëve të mitur, rishfaq interesim dhe përkushtim për t'iu bashkuar radhëve të luftës çlirimtare. Fillimisht kryen aktivitete logjistike, ndërsa në mars të vitit 1999 veshë uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

¹⁵ Hajrush Kurtaj, *Kontributi i grave dhe vajzave...*, 150-153.

Në prill të vitit 1999, forcat serbe kishin ndërmarrë ofensivë shkatërrimtare kundër disa pozicioneve të UÇK-së në Rakoc të Kaçanikut. Luftimet zhvilloheshin tejet të ashpra, ndërsa luftëtarët tanë, edhe pse të armatosur dobët, po qëndronin të patundur në llogore. Në vijën e frontit, në vendin e quajtur Përroi i Rakocit, Mukadezja ndodhej me disa luftëtarë dhe së bashku me luftëtarin Besnik Bajra, në shtëpinë e Xhemajl Sopës, predha armike e goditi shtëpinë, ku ishte barrikaduar luftëtarja Mukadeze Lika dhe luftëtarin Besnik Bajra. Pas dy orë luftimesh të ashpra, në fushën e nderit kishin rënë dëshmorë disa luftëtarë dhe shumë të tjerë ishin plagosur. Ato luftuan krahë për krahë me vëllezërit e tyre në vijën e parë të frontit, duke ndjekur shembullin e dëshmoreve Xhevë Lladrovci, Fatime Hetemi e të tjera. Në mëngjesin e 9 prillit të vitit 1999, armiku kishte sulmuar me shumë forca ushtarake Rakocin e Kaçanikut. Mukadezja është rast i veçantë.¹⁶ E njohur si Mukja, ra në altarin e lirisë në Rakoc të Kaçanikut, së bashku me shumë dëshmorë e dëshmore të tjera, të cilëve, gjatë luftës së pabarabartë me armikun gjakatar, kjo u jepte zemër e kurajë si nënëmadhja e tyre, maleve e luginave të Sharrit plak e shpesh duke u shëruar plagët e trupit e të shpirtit, kur binin pranë duarve të saj. Mukadezja ra dëshmore më 9 prill 1999. Në Zonën Operative të Nerodimes, gjatë luftës së fundit në Kosovë, nga forcat policore ushtarake serbe janë plagosur edhe këto gra dhe vajza ushtarë të UÇK-së: më 27 maj 1999, plagë të lirisë ka marrë Lumturie Bela në Gorozhup.¹⁷

Në të vërtetë, veprimtaria e gruas në luftën çlirimtare në këtë zonë, është rast që flet për një përkushtim e largpamësi të veçantë për të dhënë çdo gjë nga vetja, vetëm e vetëm që të fitohej liria dhe pavarësia për popullin shqiptar. Gruaja shqiptare, në vazhdimësi pa llogaritur asnjë çmimi, ndryshimin e realitetit të hidhur e bëri me sakrificë të shumta. Në këtë kontekst, çdo aktivitet i grave në vitet e robërisë u zhvillua sipas një morali të lartë kombëtar dhe në funksion të çlirimit të popullit dhe vendit. Për më tepër veprat e mëdha, që vajzat dhe gratë shqiptare i dhanë luftës çlirimtare do t'i qëndrojnë gjithmonë kohës. Vërtet ato ishin me dinjitet, tejet të forta përballë çdo rreziku, meqë ishin të vendosura para çdo sfide që u doli përpara. Këtë synim e arritëm falë gjakut të

¹⁶ Hajrush Kurtaj, *Kontributi i femrës në luftën çlirimtare...*, 99.

¹⁷ Hajrush Kurtaj, *Flakë e pashuar*, Prishtinë 2016.

derdhur të dëshmorëve, heronjve tanë, sidomos vajzave dhe grave të cilat i “thyen” rregullat e “lojës” dhe krahas djemve dhe burrave, ngjeshën armët dhe bënë atë që duhej të bëhej për atdhe, siç bënë edhe heroinat tona më parë, duke ndjekur shembullin e: Mbretëreshës Teutë, Tringë Smajlit, Nora Kelmendit, Shotë Galicës, Zahide Jasharit, Azë Brahimaj, Xhevë Lladrovci, Mukadeze Lika-Muhaxherit, Lumnije Rakës, Jehona Rakës, Emsale Frangut, Hyrë Eminit etj.

Pra, luftën tonë çlirimtare e ndihmuan jo vetëm ato nëna, të cilat bijtë dhe bijat e tyre ishin pjesëtarë të UÇK-së, por ishin edhe ato që kujdeseshin për shëndetin tonë, duke na strehuar përditë e përnatë, duke na siguruar ushqime si dhe përkushtim e kujdes të shtuar, që ne të ishim më të organizuar, më të fuqishëm në përmbushjen e obligimeve tona, që i kishim ndaj atdheut. UÇK-ja do ta kishte vështirë, shumë më vështirë, po të na mungonin ndihmat e kujdesi kaq i përkushtuar i grave shqiptare, të cilat bënë gjithçka që ishte e mundur për të bërë, për ta ndihmuar luftën tonë çlirimtare, gjë që e bënë me vetëdije të lartë, me gjithë shpirt e zemër.